



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2018

Lënda: Dërgohet raporti i monitorimit për 4-mujorin e parë të vitit 2017 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Të nderuar,

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, Udhëzimit plotësues Nr.2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave, Nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave, Nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, ju dërgojmë raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2018, duke analizuar performancën financiare dhe realizimin e produkteve dhe objektive.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit administron dhe menaxhon fondet buxhetore për programin:

➤ **Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**

Objektivat kryesore të këtij programi janë:

- **Zbatimi i Ligjit nr. ligjit 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore” në disa drejtime:**
- ✓ Përpunimi i kërkesave për informim nga Institucionet dhe individët dhe sigurimi i aksesit të qytetarëve në të dhëna nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, me afate për periudhën 29 nëntor 1944 – 2 korrik, 1991.

- ✓ Rritja e cilësisë së funksionimit të Autoritetit nëpërmjet procedurës së përpunimit të kërkesave për informim të individëve të prekur dhe autoriteteve kushtetuese dhe institucioneve publike.
- ✓ Sigurimi i aksesit në të dhëna për kërkuesit historianë dhe median si subjekte të parashikuara nga ligji 45/2015, nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, me afate për periudhën 29 nëntor 1944 – 2 korrik 1991.
- ✓ Mbrojtja e të dhënave e në mënyrë të veçantë e atyre të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar dhe e të dhënave personale
- ✓ Ndjekja e zbatimit të strategjive ndërsektoriale në kuadër të të drejtës për informim, lidhur me indikatorët e matshëm.

Autoriteti në përmbushje të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, për cdo kërkesë të paraqitur nga:

1. Institucionet për:

- ✓ verifikimin e zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë;
- ✓ verifikimin e kandidatëve për funksione të zgjedhshme;
- ✓ verifikimin e propozimeve për dhënie dekoratash, tituj nderi, medalje dhe titujt vendorë të nderit.

2. Individët per:

- ✓ njohje në cilësinë e; - të prekurit; - palës së tretë; - bashkëpunëtoreve; - të favorizuarëve të Ish-Sigurimit të Shtetit.
- ✓ rehabilitimin e të prekurve, të të vdekurve apo të të zhdukurve;
- ✓ dëmshpërblimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ✓ ruajtjen e të drejtave të personalitetit dhe shmangies së dëmit moral;
- ✓ qartësimin e fatit të të humburve, të të zhdukurve dhe të rasteve të pasqaruara të vdekjeve

3. Studiuesit dhe Media për qëllime:

- ✓ kërkimore;
- ✓ historike;
- ✓ edukimi.

ndjek procedurat si më poshtë:

Për cdo kërkesë të paraqitur nga Institucionet, Individët, Studiuesit dhe Media, Autoriteti:

- ✚ Pararakisht shqyrton dhe trajton në mbledhje të Autoritetit, legjitimitetin e kërkesës së paraqitur, duke vendosur ndjekjen e procedurave në vijim dhe shqyrtimin e dokumentacionit përkatës.
- ✚ Dërgon shkresat për vazhdimin e procedurës institucioneve përkatëse, për kontrollin dhe verifikimin e figurës së personave, sipas të dhënave të identitetit të tyre dhe në rast mungesë të dhënash, bën me dije shkresërit institucionin, individin, studiuesin dhe median e interesuar që ka paraqitur kërkesën, për plotësimin e të dhënave plotësuese sa më shpejt, me qëllim administrimin e dokumentacionit përkatës dhe vijimin e shqyrtimit të tij nga Autoriteti.

- ✚ Kryen procesin e verifikimit të figurës së shtetasit mbi bazën e objektit të kërkesës, si dhe mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga Autoriteti.
- ✚ Kryen procesin e deklasifikimit të dosjeve dhe bën bibliografinë e secilës (dosje formulare, dosje përpunimi, dokumente, fashikuj etj), në rastin kur dokumentacioni i administruar është i klasifikuar.
- ✚ Kryen përpunimin e dokumentacionit, para se ai t'i vihet në dispozicion kërkuesit, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin 45/2015.
- ✚ Kryen trajtimin dhe shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesi në mbledhje të Autoritetit, mbi bazën e rezultatit të verifikimit të dokumentacionit të administruar nga Autoriteti.
- ✚ Mbi bazën e rezultateve të verifikimit të kryer, bazuar në vendimarrjen konkrete të Autoritetit, informon shkresërisht institucionin, individin, studiuesin dhe median e interesuar që ka paraqitur kërkesën, sipas parashikimeve të nenit 19, 20, 21, 22, 23 dhe 24 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Treguesit për matjen e performancës do të jenë:

- Numri në rritje të kërkesave nga Institucionet, Individët, Studiuesit dhe Mediat të trajtuara nga ana e Autoritetit;
- Numrin e ankesave në raport me vendimet e marra nga ana e Autoritetit;
- Koha e trajtimit të një kërkesë

Në 4-mujorin e parë të vitit 2018, evidenca e realizimit të shpenzimeve të buxhetit për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” krahasuar me planin, paraqitet si më poshtë:

Nr	Emertimi	Buxheti Fillestar Viti 2018	Realizimi faktik 4-mujor	
			Në vlerë	Në %
1	Planifikim-Menaxhim-Administrim	47,000,000	10 342 844	22%

Përbërja e shpenzimeve buxhetore, sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, sipas buxhetit dhe realizimit faktik të 4-mujorit të parë të vitit 2018, jepet në tabelën e mëposhtme:

Llog	Emertimi	Buxheti Fillestar Viti 2018	Realizimi 4-mujori I 2018	Diferenca	
				Në vlerë	Në %
600	Fondi i Pagave	28,000,000	8,298,927	19,701,073	29.6%
601	Kontrib. Sig. Shoq & Shënd.	4,000,000	1,240,154	2,759,846	31.0%

602	Mallra dhe shërbime të tjera	13,000,000	803 763	12 196 237	6.0%
231	Kapitale të Trupëzuara	2,000,000	0	2,000,000	0.0 %
	T o t a l i	47,000,000	10 342 844	37,487,936	83%

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, për periudhën e raportuar, Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit,, ka realizuar vlerën buxhetore sa më poshtë:

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore, (zëri 600-601), është realizuar, në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me Vendimin e Kuvendit nr. 95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit”. Pavarësisht strukturës së miratuar me Vendim të Kuvendit nr. 95/2016, në të cilën janë përcaktuar numri total i punonjësve prej 60, me ligjin nr.109/2017, “Për buxhetin e vitit 2017” është miratuar numri vetëm për 30 punonjës, nga të cilët 5 janë anëtarë të Autoritetit, të zgjedhur nga Kuvendi, sipas parashikimeve të ligjit nr.45/2015. Për vitin 2018, janë miratuar edhe 6 punonjës me kontratë të përkohshme, të cilët paguhën për punën e kryer (6 orë) duke u trajtuar edhe me sigurime shoqërore

Buxheti i pagave dhe i sigurimeve shoqërore për periudhën 4-mujore 2018 është realizuar për numrin faktik të punonjësve respektivisht në vlerën **19 701 mijë lekë** për paga si dhe **2 760 mijë lekë** për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore , rreth 29.8 % kundrejt fondit të planifikuar vjetor.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602-606), për vitin 2018, është planifikuar në shumën prej 13 000 mijë lekë.

Grupi i Menaxhimit Strategjik së bashku me strukturat e prokurimit, ka vlerësuar në mënyrë permanente kostot e aktiviteteve për vitin 2018, për realizimin e objektivave afat shkurtër, duke i reflektuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

Sipas transaksioneve të kryera në Degën e Thesarit, është realizuar vlera 804 mijë lekë ose 6 %, e planit total vjetor të shpenzimeve operative.

Për mjaft shërbime Autoriteti ka realizuar prokurimet apo nënshkruar kontratat, ku shërbimi do të kryhet përgjatë gjithë vitit të kontratës, si rrjedhojë edhe pagesat do të reflektohen çdo muaj edhe për vitin në vazhdim sic mund të jenë shërbimi i internetit, i dezinfektimit, etj

➤ **Fondi për shpenzime kapitale të trupëzuara (zëri 231)**

Buxheti i akorduar për këtë zë shpenzimesh në fillim të vitit buxhetor ishte 2 000 mijë lekë e detajuar në tre projekte si më poshtë :

1- Projekti M950001- llog 231, në vlerën 2 000 mijë lekë, me emërtimin “Rikonstruksion godine”.

Krahasimi I të dhënave faktike ndërmjet Autoritetit dhe Thesarit

Nr	Shpenzimet korente	Shpenzimet kapitale		Totali	Diferenca
----	--------------------	---------------------	--	--------	-----------

	<i>Emertimi i programit</i>	Autoriteti	Thesari	Autoriteti	Thesari	Autoriteti	Thesari	
1	Planifikim - menaxhim-administrim	10 342 844	10 342 844	0	0	10 342 844	10 342 844	0

Në **Aneksin nr. 3** është paraqitur realizimi i treguesve të performancës/produkteve (në sasi dhe vlerë) nga kryerja e aktiviteteve, në zbatim të objektivave për vitin 2018.

Konkretisht si më më poshtë :

Kërkesa të përpunuara :

Më poshte po japim disa statistika për realizimin e këtij produkti:

- Janë trajtuar dhe përfunduar **27 praktika** për ish të përndjekurit politikë për dhënie përgjigje Ministrisë së Drejtësisë.
- Në zbatim të ligjit 45/2015, janë kryer verifikimet e dhënë përgjigje Drejtorisë së Informacionit për kërkesat e ardhura nga **Institucionet Kushtetuese, autoritetet publike dhe subjektet e tjera** si
 - Institucioni i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,
 - KLP,
 - MEPJ,
 - Ministria e Bujqësisë,
 - MBZHR,
 - Departamenti i Administratës Publike,
 - RTSH etj.
- Janë verifikuar dhe kthyer përgjigje pranë Drejtorisë së Informacionit kërkesave **për personat e interesuar në cilësinë e të prekurit, përfaqësuesit ligjor ose në cilësinë e të afërmëve**. Konkretisht:
 - Janar** janë verifikuar dhe kthyer përgjigje për **27** kërkesa.
 - Shkurt** janë verifikuar dhe kthyer përgjigje për **35** kërkesa.
 - Mars** janë verifikuar dhe kthyer përgjigje për **39** kërkesa.
 - Prill** janë verifikuar dhe kthyer përgjigje për **40** kërkesa.
- Gjatë periudhës Janar-Prill 2018 janë paraqitur pranë Autoritetit **36 kërkesa** studimore/mediatike
- Gjatë periudhës janar-prill 2018 janë deklasifikuar gjithsej **27 dosje**.
- Në mbledhje të Autoritetit janë trajtuar paraprakisht dhe legjitimuar **rreth 223 kërkesa individuale**. Rezulton se është mbyllur procedura për **45 kërkesa individuale**, ku janë përgatitur relacionet, materialet mbështetëse dhe vendimet dhe kthimet e përgjigjeve kërkesuesve, mbi bazën e vendimmarrjes nga Autoriteti, për përmbylljen e procedurës
- Është kryer **dixhitalizimi i rreth 11 583 fletëve**.

Gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2018 Autoriteti ka punuar ne 2 drejtime:

-Platforma “Edhe muret kanë veshë” me dëshmi gojore, dokumentar, libër në anglisht, faqe interaktive interneti

Kontakte dhe vizita me bashkitë e qyteteve Shkodër, Tiranë, Korçë, Berat, Tepelenë, Gjirokastrë.

Takime me studiues shkencore e studentë dhe përfaqësues të ish-të përndjekurve në universitetet e Shkodrës, Tiranës, Korçës, dhe Gjirokastrës.

Marrja përsipër e angazhimit për projektim dhe bashkëpunim me komunitetin për datën 8 maj. Udhëtime në qytetet e sipërpërmendura për regjistrimin e dëshmime gojore të të mbijetuarve si dhe në vende të tjera, Hani i hotit, Burrel, etj, duke zgjeruar hartën.

Regjistrimi i vazhdueshëm dëshmime gojore pranë Autoritetit, në një mjedis të krijuar enkas për këtë.

Konceptimi i platformës shqip anglisht, dizenjimi i saj në funksion të pasurimit të arkivit të dëshmime gojore të Autoritetit në vazhdimësi.

Drejtimi i dytë i projektit: konceptualizimi i kuadrit shkencor për kampet e punës së detyruar. Caktimi i bashkëpunëtorëve, Instituti i Historisë, ASH, Instituti për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe kërkues shkencorë jashtë vendit.

Përcaktimi i temave rreth të cilave mund të bëhen studimet për konferencën,

Përgatitja për thirrje e studiuesve, në bashkëpunim me të gjithë aktorët e përfshirë

Prezantim i planit për muzealizimin e Kampit të Tepelenës, në “Prezantimin e projekteve për vendet e kujtesës dhe punën aktuale të muzeve, organizuar nga OSBE, më 26 prill.

Projekti Perform, platformë komunikimi, studim shkencor i dhjetë personaliteteve nga një grup i përzgjedhur studiuesish.

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Projekti PERFORM - Shkenca Sociale Aktive dhe të Përgjegjshme, bashkëpunojnë në ndërtimin e një narrative mbi rolin e shkencës, elitave intelektuale dhe kërkimit shkencor në vitet e para të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri.

Puna me Institutin e Historisë për caktimin e një drejtuesi të grupit të studiuesve.

Paraqitja e thirrjes për pjesëmarrje.

Përzgjedhja e studiuesve.

Sfida për të ardhmen

- a. -Standard sa më të lartë informacioni, që do të thotë, së pari gjithshka që kërkohet sipas objektit të kërkesës dhe së dyti dhënia e informacionit për gjithshka të lidhur me objektin e ligjit 45/2015,
- b. Përgatitjen cilësore të materialeve informuese mbi dokumente të ish-sigurimit të Shtetit dhe vënien e tyre në dispozicion organizatorëve, në funksion të konferencave, takimeve, ëorkshopeve, programeve trajnuese, me qëllim krijimin e një kulture gjithpërfshirëse, për njohje me dokumentacionin arkivor, të krijuar nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit,
- c. Gjetjen e mënyrave dhe mjeteve më efikase për të shpërndarë informacion, si në drejtim të edukimit, sensibilizimit apo informimit të qytetarëve dhe rinisë në vecanti, nëpërmjet kumtesave në ditët kalendarike që ju përkushtohen ngjarjeve tronditëse të ndodhura mbi viktima të pafajshëm të diktaturës komunisti, mbi bazën e provave dhe fakteve të

pakontestueshme, të bëra publike për herë të parë dhe të mara autentikisht nga dosjet e krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit.

- d. Bashkëpunimin me median, të cilën e shikojmë si promotor për të gjitha grupet e interesit, vecanërisht për studiuesit, duke e kthyer këtë institucion në një bibliotekë të hapur lehtësisht të aksesueshme, për të gjithë ata që u takon me ligj, ashtu siç është emërtuar edhe vetë ky institucion.

Theksojme se, momentalisht Autoritetit i janë vënë në dispozicion disa zyra pranë Gardës së Republikës. Në lidhje me godinen pranë Ministrisë së Mbrojtjes ku do jenë zyrat definitive të Autoritetit nuk kemi fond te mjaftueshëm për të filluar rikonstruksionin e saj.

Realizimi i buxhetit për periudhën 4-mujore u monitorua me përgjegjesi dhe u kërkua angazhimi i të gjitha strukturave të AIDSSH-së me qëllim realizimin me sa më efikasitet dhe efektivitet i fondeve të planifikuara për vitin 2018. Problemat e konstatuara gjatë këtij 4 mujori do jenë objekt i vëmendjes dhe trajtimit për katërmujorin pasardhës.

Materiali është i publikuar në faqjen zyrtare të AIDSSH-së : www.autoritetidosjeve.gov.al